



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 18/5, DATË 1 / 8 /2019

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN
E INVESTIMIT “KULTIVIMI I KARKALECAVE TË DETIT NË KARAVASTA, DIVJAKË,
ZK.NR.2085, ME SUBJEKT APLIKUES ADRIATIKA HOLDING SHPK ME NUIS/NIPT
L71313025K”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 2/ç të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike pasi mori në shqyrtim projektin i investimit i cili konsiston në:

- Realizimin e një “Ferme për prodhimin e karkalecit të detit të llojit ‘Penaeus Japonicus’”, në sektorin agrikorik detar, në fshatin ‘Karavasta e Re’, në Komunën Remas, Bashkia Divjakë.
- Zona e synuar për realizimin e projektit të investimit ndodhet në ZK. Nr. 2085 dhe shtrihet në parcelat me numër: 1/2; 8/1;9/1; 7/1; 10/1; 11/1; 12/1; 13/1; 27/1; 26/1; 25/1; 24/4; 24/3; 24/4; 24/2; 2/1; 3/1; 6/1; 14/3; 14/4; 14/2; 24/1; 14/1; 15/3; 15/2; 15/1; 15/1; 16/1; 23/1; 17/1; 22/1; 4/1; 18/1; 21/1; 5/1; 19/1; 20/3; 20/5; 20/2; 20/1. Kjo zonë shtrihet në një hapësirë prej përafërsisht 400 ha.
- Vlera e synuar e investimit është rreth 4.000.000 (katër milion) Euro dhe realizimi i këtij projekti synon hapjen e 120 (njëqind e njëzet) vendeve të punës.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit të kultivimit të karkalecit të detit, në Karavasta, Divjakë, ZK. Nr. 2085, në procedurën e asistuar, pasi në referencë të legjislacionit për zonat e mbrojtura, legjislacionit për mbrojtjen e biodiversitetit, legjislacionit për zhvillimin e

akuakulturës, specia e kërkuar për t'u përdorur për kultivim është specie invazive dhe tipologjia e projektit nuk përputhet me kriteret e zonës.

2. Subjekti propozues paraqet mungesë të burimeve dhe kapaciteteve financiare, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVËNDËSKRYEMINISTËR

ERION BRAÇE

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

BLEDI ÇUÇI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ARTUR METANI

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO